



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:262909

Datë: 30.01.2021

Numri i dokumentit: 01458899

A.nr.1021/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Vjollca Limani, me zyrtaren ligjore/procesmbajtësen Gzona Rama Demaj, në konfliktin administrativ të paditëses E. G., pronare e barnatores "A.", të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av.G. S., me adresë rr."...", nr...., Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me datë 11.01.2021, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.Aprovohet kërkesëpadia e paditëses E. G., pronare e barnatores "A.", në P..

II.Anulohet vendimi Nr.10/R-99-17 i datës 06.02.2017 me numër të protokollit 05-3452/2 dhe datë 06.06.2017 i Ministrisë së Shëndetësisë Inspektorati Shëndetësorë dhe çështja kthehet në rivendosje dhe rishqyrtim te e paditura.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Seanca mbi shqyrtimin kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prezencë të paditëses dhe përfaqësuesit të saj, dhe në mungesë të palës së paditur, të ftuara në mënyrë të rregullt.

Përfaqësuesi i paditëses, av. G. S., në seancën e shqyrtimit kryesor qëndroi në tërësi si në padi, plotësim padi të datës 29.06.2020, si dhe kundërshtoi përgjigjen në padi të të paditurës. Nëpërmes padisë paditësja ka theksuar: vendimi i të paditurës nr.10/R-99-17 i datës 06.06.2017 me të cilin është refuzuar ankesa e paditëses si e pabazuar kurse është vërtetuar vendimi i Inspektoratit Farmaceutik për Paisje Medicinale nr.10/MS-002-17 i dt.04.05.2017, është jologjor sepse bazohet në konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Kështu gjatë kontrollimit nga ana e Inspektionit të të paditurës në barnatoren "A.", të cilën e menaxhon paditësja është gjetur një eksponat i vetëm i dy apo tri barnave që paditësja i ka poseduar për nevoja personale dhe kjo qenë shkak për gjobitje në vlerë prej 1000 euro. Këto eksponate barnash nuk kanë qenë të ekspozuara në vitrinë apo rafte për shitje por në tavolinë, aty ku edhe ka qenë qanta e paditëses, ndërsa në arsyetimin e vendimit të goditur thuhet se barnatorja ka poseduar produkte medicinale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, produkte pa të drejtë

autorizimi- marketingu për qarkullim në tregun e Kosovës, gjë që nuk është vërtetuar po vetëm është thënë njëanshëm pa prova materiale. Padiësja kundër të njëjtit vendim ka paraqitur ankesë e cila është refuzuar, për me tepër vendimi i shkallës së dytë përmban arsyetimin me një pretekst krejtësisht tjetër, ku thuhet se gjoba është marrë pasi farmacistja nuk ka qenë në vendin e punës, gjë që nuk është e vërtetë pasi që në procesverbal është konstatuar se pronarja ditën e inspektimit ka qenë prezentë. Pra nga kjo shihet se vendimi i shkallës së parë dhe të dytë janë në arsyetimin e tyre kontradiktore, vendimet janë shabllone pa u lëshuar fare në konstatimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes reale dhe faktike. Në seancën e shqyrtimit kryesor, mbi këtë bazë padiësja i ka propozuar gjykatës që të anulohet vendimet e të paditurës si të kundërligjshëm dhe të aprovojë padinë e saj si të bazuar.

E paditura në përgjigjen në padi të parashtruar në këtë gjykatë me datën 05.03.2019 e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses duke shtuar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala paditëse se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare pasi që vendimi i atakuar është marrë bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Mbi këtë bazë e paditura ka kërkuar nga gjykata që padia dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datë 11.01.2021 ka bërë administrimin e provave dhe atë është administruar: Vendimit nr.10/MS-002-17, i datës 04.05.2017; procesverbali i inspektimit i datës 02.05.2017; vendimi nr.10/R-99-17 i datës 06.06.2017, ankesa me nr. prot. 05-3452/2 e datës 12.05.2017; parashtrësja drejtuar Inspektoratit farmaceutik për produkte me nr. prot. 05-3322 i datës 03.05.2017; faturë me numër serik 0000128, dokumenti me lëndën "Raport i Inspektimit" me nr. prot. 05-3451 i datës 08.05.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e **bazuar**.

Me vendimin Nr.10/MS-002-17 të datës 04.05.2017, me numër të protokollit 05-3452 dhe datë 08.05.2017, gjykata gjeti se padiësja E. G. - përgjegjëse e subjektit juridik "A." me numër licencës L5/2014/02/0955 dhe numër biznesi 71023443 me seli në Prishtinë, është ndëshkuar me gjobë prej 1000€ (një mijë euro), ndërsa për procedurat tjera ligjore përgjegjëses është AKPPM në bazë të dispozitave ligjore.

Në procedurën sipas ankesës, gjykata vërejti se e paditura Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësorë, me vendimin Nr.10/R-99-17 i datës 06.06.2017, me numër të protokollit 05-3452/3 dhe datë 06.06.2017, e ka refuzuar ankesën me numër protokollit 05-3452/2 të parashtruar nga këtu padiësja, E.G.- pronare e barnatores "A."

E pa kënaqur me këto vendime, padiësja ma datën 19.06.2017, ka parashtruar padi në këtë gjykatë duke e kontestuar ligjshmërinë e tyre.

Mirëpo duke pasur parasysh se vendimi Nr.10/R-99-17 i datës 06.06.2017 i të paditurës, paraqet akt përfundimtar në procedurën administrative dhe vetëm mbi bazën e tij mund të iniciohet konflikti administrativ, gjykata vlerësoi ligjshmërinë e tij, dhe për të njëjtin gjeti se përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative.

Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Vendimi i shkallës së dytë i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në dispozitivin e tij nuk bëhet e qartë se ankesa e parashtruar kundër cilit vendimi ishte refuzuar dhe cili vendim ngelej në fuqi nëse ankesa refuzohet. Ndërsa në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.” Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se: *”Pas shqyrtimit të ankesës me numër protokollit 05-3452 e datës 12.05.2017 dhe analizimit të gjeturave të cilat janë cekur në procesverbalin e datës 02.05.2017 me numër serik 004852, të lëshuar gjatë inspektimit nga Inspektorati Farmaceutik, ku u konstatua se barnatorja në fjalë operonte pa farmacist prezent, në bazë të paragrafit 3 të nenit 6 të UA 11/2015 ku thuhet se: Barnatorja mund të funksionoj vetëm me prezencën e farmacistit, kurse në pikën 4 të nenit 6 të UA 11/2015, thuhet se: në rastet kur farmacisti nuk mund të jetë prezent në barnatore, bartësi i licencës profesionale të barnatores është i obliguar që të angazhojë farmacistin zëvendësues i cili autorizohet për kryerjen e detyrave të farmacistit. Bazuar në shkeljet e gjetura në barnatoren në fjalë, përfundimisht konsiderojmë se kjo ankesë e parashtruar nga Mr. PH E. G. themelues e barnatores “A.”, nuk përmban kurrfarë fakte të reja që e kundërshtojnë si të pabazë vendimin e shkallës së parë. Procesi është zbatuar drejtë dhe sipas dispozitave ligjore në fuqi. Vendimi i kontestuar është i bazuar në të gjeturat dhe aktet ligjore në fuqi.”*

Nga kjo, gjykata gjen se paditura ka marr një vendim pa dispozitiv të saktë dhe pa arsyetim, madje i njëjti është edhe i pakuptueshëm, dhe si tillë nuk përmban elementet kryesore të vendimit të përcaktuar me dispozitat ligjore të cekura më lartë të Procedurës Administrative, nga i njëjti shihet se nuk është trajtuar asnjë pretendim i ankueses tani paditëses të paraqitur si në ankesën me nr.prot.05-3452/2 e datës 12.05.2017.

Ndërsa marr parasysh ankesën e paraqitur nga paditësja, e cila sipas të paditurës është trajtuar me vendimin Nr.10/R-99-17 i datës 06.06.2017, me numër të protokollit 05-3452/3 dhe datë 06.06.2017, del se paditësja e kishte atakuar me ankesë vendimin e MSH-ISH me nr.10/MS-002-17 i datës 04.05.2017 me të cilin paditësja ishte ndëshkuar me gjobë në shumë prej 1000, pasi që më rastin e inspektimit të kryer na inspektorët farmaceutik për produkte dhe paisje medicinale me datë 02.05.2017 është konstatuar se barnatorja ka poseduar produkte medicinale në kundërshtim me ligjin.

Prandaj për ligjshmërinë e vendimit të atakuar gjykata i’u referua nenit 43 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, ku është përcaktuar që: *“Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”*, e që në rastin konkret nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike nga ana e organit të paditur, pasi që: nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga Procesverbali me numër 004852 të datës 02.05.2017, gjykata gjeti se Inspektorët e IFPPM kanë kryer inspektimin në barnatoren “A.”, në prani të: Mr.ph E. G. si dhe personave të autorizuar: R. M., A. D., M. S. dhe Sh. F., ku kanë konstatuar se gjatë inspektimit të janë hasur një sasi

produktesh të paautorizuara për qarkullin në territorin e Republikës së Kosovës. Më tutje të njëjtit në këtë procesverbal kanë shënuar se produktet merren nga IFPP.

Ndërsa nga Raporti i inspektimit i datës 04.05.2017 me numër Ref.No.10/MS-003-17, me numër të protokollit 05-3451 i datës 08.05.2017, në të cilin është shpjeguar inspektimi i kryer me datën 02.05.2017, gjykata vërejtë së në të njëjtin, janë theksuar faktet e njëjta që janë konstatuar në procesverbalin e inspektimit me numër serik 004852

Prandaj, duke pasur parasysh se vendimi i shkallës së parë, procesverbali dhe raporti i inspektimit si të cekura më lartë flasin se me rastin e inspektimit në barnatore janë hasur produkte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, produkte pa të drejtë autorizim marketingu për qarkullim në tregun e Kosovës dhe të njëjta ishin konfiskuar, gjykata vë në pyetje, në qudi dhe habi se si e paditura me vendimi e shkallës së dytë ka konstatuar se barnatorja funksiononte pa farmacist prezent.

Në këtë kuptim gjykata vlerëson se vendimi i të paditurës i shkallës së dytë, vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe i atakuar me padi, është në kundërshtim me konstatimet e inspektorëve të dhënë në ditën e inspektimit me procesverbalin e datës 02.05.2017 dhe Raportin e datës 04.05.2017 dhe nga provat e tilla nuk u bë e ditur se për cilin veprim paditësja ishte ndëshkuar, e po ashtu nuk u bë e ditur nëse vendimi i trajtuar me ankesë ishte vendimi mbi ndëshkimin nr.10/MS-002-17 i datës 04.05.2017.

Prandaj, gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, dhe 64 lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1021/17 datë 11.01.2021

Zyrtarja Ligjore
Gzona Rama Demaj

G j y q t a r e
Vjollca Limani

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:262909
Datë: 30.01.2021
Numri i dokumentit: 01458899